



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA
BASKETBALL FEDERATION OF KOSOVO

Nr. 541 Dt. 10.11.2021

PRISHTINË • PRIŠTINA • FRISTINA

RREGULLORE DISIPLINORE E QENDRËS NACIONALE TË BASKETBOLLIT

Federata e Basketbollit
të Kosovës

+383 48 703 333
federata@basketbolli.com

Lagja "Arbëria ", Blloku
C3 (Faza 2), Rr. Radovan
Zogoviq, Hyrja 7
10000 Prishtinë, Kosovë



REPUBLIKAT KOSOVËS
MINISTRAT E KULTURE, REZE
DOR NGRËNI



TEB
BANKA KOSOVA



kujtesa



ART
MOTION



fivestar
FITNESS & ATHLETICS



IP



STOBI
FLIPS

RUGOVE GROWZILLAS



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Në bazë të Nenit 21 alineja E të Statutit të Federatës së Basketbollit të Kosovës (në tekstin e mëtejmë "FBK"), Bordi i FBK-së në mbledhjen e mbajtur më **10.11.2021** miraton këtë:

RREGULLORE DISIPLINORE E QENDRËS NACIONALE TË BASKETBOLLIT

Neni 1 – Dispozitat e Përgjithshme

Federata e Basketbollit të Kosovës është themeluesi dhe përfituesi kryesor i Qendrës Nacionale të Basketbollit. Qendra Nacionale e Basketbollit është një njësi organizative brenda strukturës organizative të FBK-së.

Qendra Nacionale e Basketbollit menaxhohet dhe drejtohet nga mbikëqyrja e duhur dhe e mjaftueshme e FBK-së, si dhe funksionon nën ombrellën e Federatës së Basketbollit të Kosovës.

FBK si themeluese, dhe organet e saj, në veçanti Bordi Ekzekutiv, Zyra Ekzekutive, Këshilli Profesional dhe Shoqata e Trajnerëve të Basketbollit të Kosovës, marrin pjesë në baza të përhershme në menaxhimin dhe administrimin e Qendrës Nacionale të Basketbollit dhe e monitorojnë punën e saj sidomos në fushën e përgatitjes dhe zbatimit të projekteve dhe programeve profesionale.

Federata e Basketbollit të Kosovës me themelimin e Qendrës Nacionale të Basketbollit synon që në kuadër të objektivave të saj strategjike të ngritë profesionalisht nivelin e lojtarëve të talentuar të basketbollit në Kosovë, si dhe krahas kësaj të ngritë edhe nivelin e stafit menaxhues të Qendrës Nacionale të Basketbollit, duke përfshirë këtu edhe trajnerët.

Qendra Nacionale e Basketbollit e ka stafin e saj menaxhues:

- ✓ Drejtori Teknik i FBK-së, që është mbikëqyrësi i nivelit të parë të Qendrës.
- ✓ Koordinatori i Qendrës, që është përgjegjës për cështjet operacionale dhe logistike të Qendrës.
- ✓ Trajnerët, që janë përgjegjës për stërvitjet dhe për lojtarët e Qendrës.

Neni 2 – QËLLIMI

Me Rregulloren Disiplinore të Qendrës Nacionale të Basketbollit përcaktohen normat e sjelljeve dhe veprimet e stafit menaxhues, dhe lojtarëve të Qendrës Nacionale të Basketbollit.

Stafi menaxhues, trajnerët dhe lojtarët e Qendrës Nacionale të Basketbollit përveç arritjeve profesionale obligohen të kujdesen për disiplinë, shëndet, higjienë dhe rregullsinë e jetës së tyre sportive.



RUGOVE GROWZILLAS



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Stafi menaxhues, trajnerët dhe lojtarët e Qendrës Nacionale të Basketbollit duhet të jenë të vetëdijshëm se e përfaqësojnë Federatën e Basketbollit të Kosovës dhe shtetin e Kosovës, dhe me veprimet e tyre nuk duhet assesi ta dëmtojnë imazhin e FBK-së dhe të shtetit të Kosovës.

Rregullorja Disiplinore e Qendrës Nacionale të Basketbollit vlen për stafin menaxhues, trajnerët dhe lojtarët, ndërsa duhet të zbatohet në stërvitje, ndeshje, udhëtime zyrtare, pra gjatë gjithë kohës së bartjes së uniformës së FBK-së dhe përfaqësimi i shtetit të Kosovës.

Neni 3 STËRVITJA

3.1

Trajnerët dhe lojtarët duhet që të jetë gatshëm për stërvitje 15 minuta para fillimit të saj.

Vonesat në stërvitje nuk janë të lejuara përveç, nëse trajnerët apo lojtarët të cilët janë vonuar kanë arsyë objektive për vonesë.

3.2

Stafi menaxhues dhe trajnerët në stërvitje të Qendrës Nacionale të Basketbollit duhet ti përbushin kërkesat dhe pritshmëritë e Federatës së Basketbollit të Kosovës në mënyrë që stërvitja të jetë kualitative.

3.3

Lojtarët në stërvitje të Qendrës Nacionale të Basketbollit të Kosovës duhet ti përbushin kërkesat dhe pritshmëritë e trajnerëve në mënyrë që stërvitja të jetë sa më kualitative.

3.4

Gjatë kohëzgjatjes së stërvitjes lojtarët nuk kanë të drejtë të bisedojnë me spektatorët e pranishëm në stërvitje.

3.5

Është e ndaluar fjalosja dhe konflikti fizik i lojtarëve në stërvitje. Nëse ndodh një gjë e tillë atëherë lojtarët e përfshirë mund të suspendohen nga Qendra Nacionale e Basketbollit deri në përfundim të procedurës disiplinore, me propozim të stafit menaxhues të Qendrës Nacionale të Basketbollit.

3.6

Trajneri mund ta largoj lojtarin nga stërvitja nëse ai lojtar nuk është i koncentruar në stërvitje, nuk është i motivuar dhe nuk angazhohet maksimalisht në kryerjen e detyrave të caktuara nga trajneri.

3.7

Lojtarë i cili është përjashtuar nga stërvitja është i detyruar të qëndrojë në palestër deri në përfundim të stërvitjes, përveç nëse trajneri vendos ndryshe.

**Federata e Basketbollit
të Kosovës**

+383 48 703 333
federata@basketbolli.com

Lagja "Arbëria ", Blloku
C3 (Faza 2), Rr. Radovan
Zogoviq, Hyrja 7
10000 Prishtinë, Kosovë

REPUBLIKAT KOSOVËS
MINISTRATË SË SPORTIT
PËR SPORË

TEB
TURKISH EXIM BANK

kujtesa

ART
MOTION

fivestar
FITNESS & ATHLETICS

IP

STOBEL
FLIPS

RUGOVE GROWZILLAS



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

3.8

Lojtarët e Qendrës Nacionale të Basketbollit kanë të drejtë të stërviten në Qendër, të luajnë për klubet e tyre, por assesi të stërviten në mënyrë individuale me trajnerë që nuk janë pjesë e Qendrës Nacionale të Basketbollit. Në rast se lojtari apo lojtarët fillojnë të stërviten individualisht me trajnerët që nuk janë pjesë e programit të Qendrës Nacionale të Basketbollit, atëherë stafi menaxhues i Qendrës në bashkëpunim me trajnerin mund të marrin vendim për përjashtimin e lojtarit në fjalë nga Qendra Nacionale e Basketbollit.

3.9

Lojtari nuk ka të drejtë të përdor mjete stimuluese, të cilat ndodhen në listën e ndaluar të institucioneve ndërkombëtare dhe kombëtare. Për thyerjen e këtij Neni do të pasojë përjashtimi nga Qendra Nacionale e Basketbollit.

3.9.1

Çdo lojtar, i cili lëndohet në stërvitje apo në ndeshje, duhet që ta paraqet lëndimin tek stafi menaxhues i Qendrës Nacionale të Basketbollit.

3.9.2

Lojtari është i obliguar që ta mbajë higjienën personale, në mënyrë që mos të vihet në pyetje puna normale në stërvitje, si dhe të mos rrezikohet puna normale e Qendrës në stërvitje.

3.9.3

Pas përfundimit të stërvitjes lojtar duhet të shkoj në teshatore, përvèç rasteve kur trajneri kërkon nga ai që të mos e bëjë një gjë të tillë. Lojtar duhet të largohet prej teshatores i veshur në mënyrë të përshtatshme, varësisht nga situata meteorologjike.

Neni 4 – NDESHJA

4.1

Para secilës ndeshje nëse trajneri mban mbledhje, ku të gjithë lojtarët duhet të jenë të pranishëm, derisa kohën e mbledhjes e cakton stafi menaxhues i Qendrës Nacionale të Basketbollit në koordinim me trajnerët.

4.2

Para fillimit të ndeshjes lojtarët është i obliguar të jetë në palestër së paku një (1) orë para fillimit të ndeshjes në teshatore, ose në kohën të cilën e cakton trajneri, me veshje adekuate sportive.

4.3

Lojtarët duhet të dal me skuadrën bashkë në nxehje para ndeshjes, i koncentruar maksimalisht për ndeshje, duke mos pasur kontakte me persona të tjerë, të cilët nuk gjinden në protokollin zyrtar të ndeshjes.

4.4

Lojtarët është i obliguar që të nxehet sipas udhëzimeve të trajnerëve, me një angazhim maksimal dhe pa vërejtje.

**Federata e Basketbollit
të Kosovës**

+383 48 703 333
federata@basketbolli.com

Lagja "Arberia ",Blloku
C3 (Faza 2),Rr. Radovan
Zogoviq,Hyrja 7
10000 Prishtinë, Kosovë

REPUBLIKAT KOSOVES
MINISTRIA E KULTURE, VJENËS
DHE SPORTIT

TEB
TIRANA ECONOMIC BANK

kujtesa

**ART
MOTION**

**fivestar
FITNESS & ATHLETICS**

IP

**STOP
FLIPS**

RUGOVE GROWZILLAS



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

4.5

Rreptësishtë ndalohet komunikimi me publikun gjatë ndeshjes, fyerjet dhe sjellja jo-sportive ndaj publikut, si dhe kacafytja eventuale me publikun.

4.6

Lojtari në asnjë mënyrë nuk duhet të bëjë sjellje të pahijshme, për të treguar pakënaqësi për vendimet e trajnerëve, si p.sh. për ndërrim gjatë ndeshjes, apo të jetë i pakënaqur me konceptin e lojës.

4.7

Lojtari gjatë ndeshjes nuk duhet assesi të bisedojë me gjyqtarët e ndeshjes dhe të diskutojë rreth vendimeve të tyre. Lojtari, i cili merr gabim teknik apo përjashtohet, do të suspendohet sipas vendimit të stafit menaxhues të Qendrës Nacionale të Basketbollit.

4.8

Lojtari në secilën ndeshje së bashku me bashkëlojtarët, para dhe pas ndeshjes duhet ta përvendet publikun.

Neni - 5 UDHËTIMET dhe PËRGATITJET

5.1

Stafi menaxhues, trajnerët dhe lojtarët janë të obliguar që 15 minuta para nisjes të jenë në vendin e caktuar për nisjes.

5.2

Gjatë udhëtimeve, akomodimit në hotel, lojtari duhet që të sillet në mënyrë korrekte dhe me sportivitet, me të gjithë stafin me të cilin takohet gjatë udhëtimit apo akomodimit.

5.3

Gjatë udhëtimeve, akomodimit lojtari duhet të ushqehet sipas urdhrove të stafit menaxhues dhe trajnerëve. Është e ndaluar gjatë mëngjesit, drekës, darkës të përdoret telefoni mobil.

5.4

Pas përfundimit të racionit, trajneri kryesor është ai jep leje që skuadra mundet ta lëshoj sallën e ushqimit. Kohën e lirë dhe të pushimit e cakton stafi menaxhues i Qendrës Nacionale të Basketbollit. Lojtari nuk mund të porosit ushqim dhe pije, edhe nëse e paguan individualisht, pa lejen e stafit menaxhues të Qendrës Nacionale të Basketbollit.

5.5

Lojtari është i detyruar që në fillimin e vitit të dytë të Qendrës Nacionale të vij me përgatitje maksimale fizike. Shkuarja në stërvitje, ndeshje kur skuadra është në përgatitje ose në karantinë është kolektive, derisa udhëtimi në ndonjë qytet apo shtet tjetër me uniforma të njëjtë.

**Federata e Basketbollit
të Kosovës**

+383 48 703 333
federata@basketbolli.com

Lagja "Arbëria ", Blloku
C3 (Faza 2), Rr. Radovan
Zogoviq, Hyrja 7
10000 Prishtinë, Kosovë

REPUBLIKA E KOSOVËS
MINISTRIA E VJEDULLËS SË KOSOVËS
DIPLOMAKATË

TEB
BANKA PRAVDA, KREDITI, INVESTIMI

kujtesa

ART
MOTION

fivestar
FITNESS & ATHLETICS

IP

Stobi
FLIPS

RUGOVE

GROWZILLAS



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Neni 6 - PËRKUJDESJA MJEKËSORE

6.1

Lojtarët janë të obliguar të marrin pjesë në kontrollimet mjekësore, matjet, të cilat janë të parapara me planin dhe programin profesional të Qendrës Nacionale të Basketbollit. Lojtarët janë të obliguar që të përkujdesen, për kontrollim sistematik të dhëmbëve.

6.2

Në rast të ndonjë lëndimi të stafit menaxhues, trajnerëve e lojtarëve në kuadër të stërvitjeve/ndeshjeve të Qendrës Nacionale të Basketbollit, është Federata e Basketbollit të Kosovës, ajo që do të marr përsipër të gjitha shpenzimet e këtyre lëndimeve.

Neni 7 - SHKOLLIMI

Lojtarët e Qendrës Nacionale të Basketbollit duhet të jenë nxënës të rregullt, si dhe ti vijojnë mësimet në mënyrë të rregullt. Duhet që sjelljen ta kenë shembullore, ndërsa suksesin më së paku shumë mirë. Lojtarët të cilët nuk e vijojnë procesin mësimor në mënyrë të rregullt, kanë sjellje të dobët dhe sukses të dobët, me vendim të stafit menaxhues do të propozohen që të përjashtohen nga Qendra Nacionale e Basketbollit.

Neni 8 - DISPOZITAT TJERA

8.1

Lojtarët e Qendrës Nacionale të Basketbollit vazhdimisht do të jenë mbikëqyrje të plotë të stafit menaxhues të Qendrës.

8.2

Lojtarët e Qendrës Nacionale të Basketbollit duhet të jenë në gjumë para orës 23:00.

8.3

Lojtarët e Qendrës Nacionale të Basketbollit duhet që mos ta përdorin telefonin pas orës 21:00.

8.4

Kohën e fjetjes, zgjimit e pushimit në periudhën e qëndrimit të përbashkët të skuadrës në përgatitje, udhëtime, kampe, e përcaktor trajneri i Qendrës Nacionale të Basketbollit.

8.5

Federata e Basketbollit të Kosovës ka të drejtë që ta shkëpusë kontratën për ngritje profesionale të lojtarit të Qendrës Nacionale të Basketbollit, në dëm të lojtarit, nëse lojtari i shkel Nenet nga kjo Rregullore në mënyrë konstante.

Neni 9- DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Bordi i Federatës së Basketbollit të Kosovës si organ përgjegjës për zhvillimin e basketballit në vendin tonë ka të drejtë të ndryshojë Rregulloren Disiplinore të Qendrës Nacionale të Basketbollit në dobi të avancimit dhe funksionalizimit sa më të mirë të Qendrës.

Federata e Basketbollit
të Kosovës

+383 48 703 333
federata@basketbolli.com

Lagja "Arbëria ", Blloku
C3 (Faza 2), Rr. Radovan
Zogoviq, Hyrja 7
10000 Prishtinë, Kosovë

REPUBLIKAE KOSOVES
MINISTERIA E KULTURES, REKRE
ZION SHTETËSE

TEB
BANKA PËR POKERT

kujtesa

ART
MOTION

fivestar
FITNESS & ATHLETICS

IP

STOB
FLIPS

RUGOVE GROWZILLAS



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Neni 10 - HYRJA NË FUQI

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit të saj nga Bordi i Federatës së Basketbollit të Kosovës.

Miratuar në Prishtinë, më 10.11.2021

Në emër të Bordit të FBK-së,

Arben FETAHU

Kryetar

Federata e Basketbollit të Kosovës



Federata e Basketbollit të Kosovës

+383 48 703 333
federata@basketbolli.com

Lagja "Arbëria", Blloku
C3 (Faza 2), Rr. Radovan
Zogoviq, Hyrja 7
10000 Prishtinë, Kosovë



kujtesa



fivestar
FITNESS & ATHLETICS



STOBEL
FLIPS

RUGOVE GROWZILLAS